

TRIPLE Auditing

LIRI GJOKA

Nr.Liçense 271,date 27.08.2012

**RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR
PER AUDITIMIN LIGJOR TE FONDEVE TE PERFITUARA DHE TE SHPENZUARA
PER FUSHATEN ZGJEDHORE PER ORGANET E QEVERISJES VENDORE
PERIUDHA 30 QERSHOR 2019**

Rruga "Ymer Kurti",Njesia Bashkiake Nr.5,Qendra Tregtare Olympia,prane Postes Nr.8, Kati 1, Nr.19,Kutia postare 1019
E-mail:lirigjoka@yahoo.com mob:+355692033377

Tirane, Albania

TABELA E PERMBAJTJES

- Opinioni vecante i audituesit te pavarur
- Pasqyra e te ardhurave (Financimet dhe Donacionet)
- Pasqyra e Shpenzimeve (Perdorimi i fondeve sipas destinacionit)
- Te dhena te pergjithshme mbi Subjektin Zgjedhor P.L.P.SH

Referencat Ligjore:

Per kryerjen e ketij misioni jemi mbeshtetur ne perputhje me:

- Standartet Nderkombetare te Auditimit ne reference te vecante ne SNA 800
- Ligji Nr.10019,date 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikes se Shqiperise”
- Ligji Nr.10091,date 05.03.2009 “Per auditimin ligjor,organizimin e profesionit te Ekspertit Kontabel te Regjistruar (Audit Ligjor) dhe Kontabilistit te Miratuar”
- Ligji Nr.9228,date 29.04.2004 “Per kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”
- Cdo document ligjor te marre prane Partise Levizja Punetore Shqiptare (P.L.P.SH)



**RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR MBI ANGAZHIMET E AUDITIMIT PER QELLIME TE VECANTA
MBI AUDITIMIN E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE TE PARTISE LEVIZJA PUNETORE SHQIPTARE
(P.L.P.SH)**

Drejtuar: Komisionit Qendror te Zgjedhjeve

Adresa: Rruga "Ibrahim Rrugova", Nr.4 Tirane, Shqiperi

Partia Levizja Punetore Shqiptare (P.L.P.SH)

Adresa: Rruga "Beqir Sulo Agalliu", Banesa 814/I, "Lagja Lirim " Vlore , Shqiperi

Te nderuar zoterinj,

Une,Liri Gjoka ne cilesine e Ekspertes Kontabel te Autorizuar (Auditues Ligjor),jam caktuar me Vendimin Nr.740,date 31.05.2019 nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,per kryerjen e auditimit te fondeve te perfituara dhe shpenzimeve te kryera per fushaten zgjedhore per organet e qeverisjes vendore te Shqiperise, te dates 30.06.2019, per Partine Levizja Punetore Shqiptare (P.L.P.SH).

Une kam audituar pasqyren (formatin e standardizuar te raportimit financiar te fushates zgjedhore) te fondeve te perfituara dhe te shpenzuara per fushaten zgjedhore te Partise per zgjedhjet vendore per periudhen 30 Qershor 2019,miratuar me vendimin e KQZ-se, Nr.256 date 08.05.2019.

Kjo pasqyre (deklarata) eshte pergatitur nga Partia Levizja Punetore Shqiptare (P.L.P.SH).

bazuar ne librin e llogarive te Partise dhe rregjistrin te posacem,miratuar si model me vendim te KQZ-se,te cilet jane mbajtur per te pasqyruar te gjitha transaksionet ne lidhje me fushaten zgjedhore,qe kane dhene bazen per pergatitjen e pasqyrave te te ardhurave monetare-financime jo publike,te ardhurave ,dhurime ne natyre-financime jo publike,kredite e borxhet e tjera,shpenzime,shpenzimet per mitingjet e fushates etj.

Drejtimi i subjektit zgjedhor eshte pergjegjes per paraqitjen e sinqerte te burimeve te fondeve te perfituara dhe te shpenzuara ne perputhje me kodin zgjedhor dhe standarteve te kerkuara.

Rruga "Ymer Kurti",Njesia Bashkiake Nr.5,Qendra Tregtare Olympia,prane Postes Nr.8, Kati 1, Nr.19,Kutia postare 1019
E-mail:lirigjoka@yahoo.com mob:+355692033377

Tirane, Albania



TRIPLE Auditing

LIRI GJOKA

Nr.Liçense 271,date 27.08.2012

Kjo perfshin:Deklarimin e burimeve te fondeve te perfituara nga subjekte publike dhe jo publike,publikimin e personave fizike dhe juridike vendas dhe dhurimet e formave te ndryshme mbi vleren 100.000 leke,justifikimin e shpenzimit te fondeve te perfituara me dokumenta qe percaktohen ne Legjislacionin Tatimor,zbatimin korrekt te kerkesave sipas percaktimit te bere ne kapitullin e financimeve te fushtaes ne Kodin Zgjedhor.

Pergjegjesia ime eshte te shpreh nje opinion mbi pasqyrat (deklaraten),bazuar ne opinionin tim si auditues i pavarur.

Une kam kryer auditimin ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit ne reference te vecante me SNA 800 "Konsiderata te vecanta-auditimet e pasqyrave financiare te pergatitura sipas kuadrove per qellime specifike".

Keto standarte kerkojne qe une te veproj ne pajtim me kerkesat e etikes dhe te planifikoj e te kryej auditimin per te marre siguri te arsyeshme per faktin qe pasqyrat financiare te fondeve te perfituara dhe shpenzimet e kryera per fushaten e zgjedhjeve per organet e qeverisjes vendore,te mos permbajne anomali materiale.

Auditimi perfshin kryerjen e procedurave per sigurimin e te dhenave te auditimit per shumat dhe deklarimet ne pasqyrat financiare.Procedurat e zgjedhura jane ne gjykimin e audituesit,duke perfshire vleresimin e rrezikut te anomalive materiale,qofte si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve.

Gjate vleresimit te ketyre rreziqeve,audituesi merr ne konsiderate kontrollin e brendshem te Partise ne lidhje me pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te pasqyrave financiare,me qellim qe ai te percaktoje procedurat e auditimit qe jane te nevojshme per rrethanat financiare,por jo me qellim qe te shprehe nje opinion per efektivitetin e kontrollit te brendshem te Partise.

Auditimi perfshin gjithashtu shqyrtimin mbi bazen e testeve,te fakteve qe mbeshtetin shumat dhe deklarimet ne pasqyrat financiare,vleresimin e pershtatshmerise se metodave kontabel te perdorura dhe arsyeshmerine e cmuarjeve kontabel te bera nga drejtimi i Partise Levizja Punetore Shqiptare (P.L.P.SH),si dhe me vleresimin e paraqitjes se pergjithshme te ketyre pasqyrave.

Une cmoj se evidenca e auditimit qe une kam siguruar eshte e mjaftueshme dhe e pershtatshme per te dhene nje baze per opinionin tim te auditimit.

Detyra e subjektit zgjedhor eshte te pergatise pasqyren financiare mbi bazen e arketimeve dhe pagesave.

Per mendimin tim,pasqyra e fondeve te perfituar dhe te shpenzuara per fushaten zgjedhore per zgjedhjet per organet e qeverisjes vendore te Shqiperise per periudhen 30.06.2019 te Partise Levizja Punetore Shqiptare (P.L.P.SH),eshte pergatitur ne respekt te ligjit dhe ne perputhje me Kodin Zgjedhor te Republikes se Shqiperise.

Rruga "Ymer Kurti",Njesia Bashkiake Nr.5,Qendra Tregtare Olympia,prane Postes Nr.8, Kati 1, Nr.19,Kutia postare 1019
E-mail:lirigjoka@yahoo.com mob:+355692033377


Tirane, Albania



TRIPLE Auditing

LIRI GJOKA

Nr.License 271,date 27.08.2012



Tirane,me 14.12.2019

Rruga "Ymer Kurti",Njesia Bashkiake Nr.5,Qendra Tregtare Olympia,prane Postes Nr.8, Kati 1, Nr.19,Kutia postare 1019
E-mail:lirigjoka@yahoo.com mob:+355692033377

Tirane, Albania

TE DHENA TE PERGJITHSHME MBI SUBJEKTIN ZGJEDHOR

Subjekti zgjedhor Partia Levizja Punetore Shqiptare (P.L.P.SH),eshte rregjistruar me vendim te Gjykates vendim nr.1791,date 01.06.2000.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatese te Ligjit Nr.8580,date 17.02.2000 "Per Partite Politike",i ndryshuar me Ligjin Nr.90/2017.

Qellimi dhe objektivat e kesaj Partie,Partia Levizja Punetore Shqiptare (P.L.P.SH), gjejne pasqyrim te qarte ne programin dhe statutin e saj.

Subjekti zgjedhor Partia Levizja Punetore Shqiptare (P.L.P.SH),eshte nje bashkim vullnetar,politik dhe krijohet nga nje grup personash qe perfaqesojne Levizjen Punetore Shqiptare,me synimin perfaqesimin politik te ketij grupi dhe e ushtron veprimtarine e saj ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.

Selia e Partia Levizja Punetore Shqiptare (P.L.P.SH), eshte *Rruga "Beqir Sulo Agalliu", Banesa 814/1, Lagja "Lirim" Vlore, Shqiperi*

Burimet e financimit jane:

- Buxheti i Shtetit Financuar per fushate – 0 leke
- Te ardhura monetare financime jopublike – 0 leke
- Te ardhura,dhurime ne natyre financime jopublike – 0 leke
- Te ardhurat nga kredite - 0 leke
- Te ardhura nga kuotat e antaresise dhe ndihma nga anetaret e Partise – 0 leke

• PERMBLEDHESE E POLITIKAVE DHE RREGULLAVE KRYESORE KONTABEL

a. Menyra e pergatitjes se Pasqyrave Financiare (Formati tip i raportimit)

Pasqyrat Financiare jane pergatitur ne te gjitha aspektet e tyre materiale ne perputhje me Standartet Kombetare te Raportimit Financiar,te cilat perfshijne rregullat e percaktuara ne Ligjin Nr.9228,date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe vendimit te KQZ-se Nr.256,date 08.05.2019.

Pasqyrat e paraqitura ne raport jane shprehur ne monedhen vendase ne leke.

b. Rregullat per vleresimin e te ardhurave dhe shpenzimeve:



TRIPLE Auditing

LIRI GJOKA

Nr.Liçense 271,date 27.08.2012

- Te Ardhat


Te ardhurat jane zero leke

- Shpenzimet

Detyrimet,ose shpenzimet jane zero leke

Fushata eshte kryer nepermjet rrjeteve sociale dhe komunikimeve direkte dhe telefonike.

Tirane,me 14.12.2019.



Rruga "Ymer Kurti",Njesia Bashkiake Nr.5,Qendra Tregtare Olympia,prane Postes Nr.8, Kati I, Nr.19,Kutia postare 1019
E-mail:lirigjoka@yahoo.com mob:+355692033377

Tirane, Albania
